

KA.nr.1253/2013

KOSOVA		REPUBLIC OF KOSOVO	
KOSOVSKA RADOVINA		KOSOVO POLICE	
KOSOVSKA RADOVINA		KOSOVO POLICE	
Dep.	DPE/OMP	Nr. P. R.	03-4395/13
Dep.		Sh. Nr.	
Dep.		Pr. Nr.	
Nr. i...		Ditë	
Isht...	02	Qytet	23.12.2013
Nr. i...		Ditë	

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq kryetare e kolegji, Dalip Bega dhe Mejreme Zekaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga mbrojtësi i të pandehuri Shiqeri Luzha, avokati Selim Idrizi, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Divizionit për Kundërvajtje në Kaçanik, R.I.Nr.2124/2012, të dt. 28.10.2013, në bazë të nenit 31 al.3, 39, dhe nenit 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt. 29.11.2013, murr:

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Divizionit për Kundërvajtje në Kaçanik, R.I.Nr.2124/2012, të dt. 28.10.2013, ashtu që ndaj të pandehurit Shiqeri Luzha nga fshati Begrac, Komuna e Kaçanikut, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform të nenit 198 al.1 pika 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak të parashkrimit relativ, për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Divizionit për Kundërvajtje në Kaçanik, me aktvendimin R.I.Nr.2124/2012, të dt. 28.10.2013, të pandehurin Shiqeri Luzha nga fshati Begrac, Komuna e Kaçanikut, e ka shpallur përgjegjës sepse:

I pandehuri në cilësinë e Zyrtarit të Lart Publik, në pozitën e këshilltarit komunal në Asamblenë Komunale në Kaçanik, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë pran Agjencisë Kundër Korrupsionit, deri me dt. 31.03.2012, me ç, veprim ka krye kundërvajtje nga neni 8 par.1 sanksionuar si pas nenit 17 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lart Publik dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtar, Nr.04/L-050, për të cilën kundërvajtje, konform nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtje ia shqiptoi gjobën në shumë prej 300 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajnë shumën prej 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit Shiqeri Luzha, avokati Selim Idrizi, për shkak të shkeljes esenciale të normave të procedurës për kundërvajtje dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, shton: është e vërtet se i pandehuri ka bërë deklarin e pasurisë pran organit kompetente, jo në kohën e duhur, mos lajmërimi me kohë e prejardhjes së pasurisë nga i pandehuri, nuk ka prodhuar pasoja të dëmshme, sepse vonesa nuk është bërë me qëllim të fshehjes së pasurisë, por vetëm për shkak të neglizhencës. Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe ndaj të pandehurit të pezullohet procedura për kundërvajtje.

03-4395/13/02
fung

Kolegji i Gjykatës së Apelit-Divizioni për Kundërvajtje, duke e vlerësuar ankesën e parashtruar nga i pandehuri, aktvendimin e goditur, deklaratën e të pandehurit Shiqeri Luzha, dëshminë e dëshmitarit Enis Sadiku-zyrtar i lart i Agresionit Kundër Korrupsionit, Bejtulla Dalloshi, zyrtar për kontakte dhe shkresat tjera nga lënda, konstatoi se ankesa e paraqitur është e bazuar, ndërsa aktvendimin e goditur e ndryshoi ashtu që ndaj të pandehurit Shiqeri Luzha, nga fsh. Begracë, PEZULLOJ procedura për kundërvajtje, konform nenit 198 al.1, pika 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak të parashkrimit relativ, për zhvillimin e procedurës për kundërvajtje.

Kolegji mur këtë vendim duke u bazuar në faktin se Gjykata e shkallës së parë të pandehurin Shiqeri Luzha e ka marrë në pyetje lidhur me kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në bar më dt. 27.08.2012, ndërsa veprimin tjetër, marrjen në pyetje të dëshmitarit Bejtulla Dalloshi, zyrtar për kontakte e ka bërë me 24.10.2013, nga ky konstatim konfirmohet se veprimi për ndërprerjen e rrjedhës së parashkrimit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, është bërë pas 1. viti e 2. muaj, gjë që në vështrim të nenit 27 al. 3. të Ligjit mbi Kundërvajtjet, Kolegji i kësaj gjykate duke mos vlerësuar dhe shqyrtuar më tej thëniet në ankesën e parashtruar si dhe faktet tjera lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike, konform nenit 198 al.1 pika 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet e Pezulloj procedurën për kundërvajtje ndaj të pandehurit Shiqeri Luzha.

Më sa u tha më lartë konformë nenit 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

KA. nr.1253/2013, të dt. 29.11.2013.

PROCESMBAJTËSJA

Sebahate Hoti



KRYETARJA E KOLEGJIT

Bljana Rexhiq